



Republika e Kosovës
Republika kosova • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit te Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 2716/2018
Nr.i fol/Br.str./Nr.pg. _____
Data/Datum/Date: 24/12/2018



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 24 dhjetor 2018

Z. Sakip Imeri, Drejtor i Përgjithshëm
Administrata Tatimore e Kosovës
Rr. "Nëna Terezë", ish-Ndërtesa e Gërmisë
10000 Prishtinë

LETËR REKOMANDIM

Ankesa nr. 784/2018

Imer Abdyli
kundër
Administratës Tatimore të Kosovës

I nderuari z. Imeri,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 17 tetor 2018, ka pranuar ankesë nga z. Imer Abdyli, pronar i ndërmarrjes Fam Gas LLC, parashtruar kundër Administratës Tatimore të Kosovës (ATK).

Sipas pohimeve të z. Abdylit, ATK-ja nuk ia ka pranuar atij TVSh-në e zbritur nga Deklarata Unike Doganore (DUD). Lidhur me këtë çështje, z. Abdyli pohon se ndërmarrja që ai e drejton ka lidhur marrëveshje (të vërtetuar te noteri) me ndërmarrjen Mazrek Comerc NTP, ku këto dy ndërmarrje janë pajtuar që DUD-i nr. 14464, i datës 11 shtator 2013, dhe DUD-i nr. 14451, i datës 16 shtator 2013, të evidencohet si kosto e blerjes tek Fam Gas LLC dhe të kreditohet TVSh-ja, pasi që Fam Gas LLC paraprakisht ka bërë shitje dhe nuk e ka kredituar TVSh-në në blerje me procedurë të zhdoganimit të mallit IM7 në IM4. Ankuesi pretendon se ATK-ja, me veprime të tilla, po i shkel të drejtat e tij, sepse po ia mohon atij marrëveshjen e vërtetuar para noterit, me të cilën ai e ka marrë në pronësi DUD-in e theksuar më sipër.

Lidhur me këtë çështje, më 16 nëntor 2018, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë ATK-së, me ç' rast ka kërkuar informacione për veprimet e ndërmarra dhe veprimet që planifikon t'i ndërmerr ATK-ja përkizazi me këtë çështje. Po ashtu, ka kërkuar informata për bazën ligjore lidhur me veprimet e ATK-së.

Më 4 dhjetor 2018, ATK-ja i ka kthyer përgjigje Avokatit të Popullit dhe e ka njoftuar se veprimet e ATK-së lidhur me këtë çështje bazohen në nenin 37, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, i cili përcakton:

"2. Për të ushtruar të drejtën e tij për zbritje të TVSh-së së zbritshme, personi i tatueshëm duhet që së paku:

2.1. në lidhje me të gjitha zbritjet e referuara në kreun e 13 të mbajë një faturë ose një dokument që shërben si faturë në pajtueshmëri me kreun 15 të këtij Ligji në lidhje me zbritjet sipas nën-paragrafit 2.2 të nenit 36 të këtij ligji të ketë një dokument importi "Dokumenti Unik Doganor - DUD" në të cilin ai është i cekur si pranues i dërgesës apo importues dhe i cili e cek shumën ose mundëson llogaritjet e obligimit tatimor."

Avokati i Popullit vëren se çështja e ngritur nga z. Avdyli ka të bëjë me të drejtën e pronës, e cila është e “garantuar” me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 46, paragrafi 1).

Për më tepër, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se, sipas Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve LMD, ku përcaktohet: “*Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të lirë, që në pajtim me dispozitat urdhëruese, të rendit publik dhe të dokeve të mira, t'i rregullojnë marrëdhëniet e veta sipas vullnetit të tyre*” (neni 2); e po ashtu përcaktohet: “*Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës*” (neni 15).

Në anën tjeter, Avokati i Popullit vëren se, sipas Ligjit nr. 03/L-010 për Noterinë, si funksion notierial konsiderohet edhe “*përpilimi dhe vërtetimi i kontratave*” (neni 29, paragrafi 1.6).

Avokati i Popullit konsideron se lidhja e kontratës, sipas së cilës e drejta pronësore mbi DUD-in është bartur nga Mazrek Comerc NTP tek Fam Gas LLC, është e plotfuqishme përfaktin se kjo kontratë është lidhur në pajtim me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve si dhe me dispozitat e Ligjit për Noterinë. Prandaj e njëjtë duhet të merret parasysh nga ana e ATK-së.

Shqyrtimi i kësaj çështjeje nga ATK-ja, duke u bazuar vetëm në dispozitat e nenit 37 të Ligjit nr. 03/L-146 për Tatimin në Vlerën e Shtuar, duke mos e marrë parasysh faktin se një e drejtë pronësore mund të bartet nga njëri subjekt tek tjetri në pajtim me LMD-në, cenon të drejtën pronësore. Ky konstatim bëhet edhe më i qëndrueshëm përfaktin se nga procedurat e kontrollit ka rezultuar se në rastin konkret nuk ka shmangie tatimore dhe doganore.

Prandaj, Avokati i Popullit i:

REKOMANDON

Administratës Tatimore të Kosovës

- *Ta shqyrtojë kërkesën e Ndërmarrjes Fam Gas LLC dhe të vendosë lidhur me këtë çështje, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me KEDNj-në, me Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me Ligjin nr. 03/L-010 për Noterinë dhe me Ligjin nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), mirësish ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit